V E N D I M
Nr.603, datë 20.12.1994

PËR ARKËTIMIN E VLEFTËS SË ARKAVE REGJISTRUESE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Të gjithë personat fizikë e juridikë që janë pajisur me arka regjistruese dhe nuk kanë bërë likuidimin e vleftës së tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.43, datë 14.2.1994, detyrohen të arkëtojnë shumën e caktuar në favor të buxhetit të shtetit, brenda datës 15 janar 1995.

2. Për personat fizikë e juridikë që nuk kanë arkëtuar shumën e caktuar brenda këtij afati, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.7681, datë 9.3.1993 "Për administrimin e tatimeve dhe të taksave në Republikën e Shqipërisë", nga organet tatimore dhe të policisë financiare të bllokohen menjëherë lokalet ose njësitë e tjera të tyre dhe të sekuestrohet një sasi malli, vlefta e faturuar e blerjes së të cilës të jetë nga një deri në dyfishin e vleftës së arkës regjistruese të palikuiduar.

3. Malli i sekuestruar të trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Vlefta e marrë nga shitja e mallrave të sekuestruara të arkëtohet në favor të buxhetit të shtetit në degët e thesarit të rretheve përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi